



Datë: 22.04.2025
Numër Protokolli: 2725/2025

A.nr.349//2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktari, kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Atdhe Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.349/2025, të datës 21.02.2025, të parashtruar nga ankuesi A.G., kundër organit të punësimit/Komuna e Prishtinës, në çështjen juridike “*kompensim material*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 22.04.2025, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa me numër A.nr.349/2025, e datës 21.02.2025, e parashtruar nga ankuesi A.G.

A r s y e t i m

Nëpunësi Civil, A.G. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 21.02.2025 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 1173/2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr.14-101/03-0167712/24 të datës 20.12.2024, të Menaxherit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa kjo e fundit, më datë 24.03.2025 ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës. Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) duke ju referuar shkresave të lëndës të parashtruar nga palët në procedurë ka gjetur se ankesa e datës 21.02.2025, e parashtruar nga ankuesi, **është e pasafatshme**, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas Akt emërimit AE.Nr.01-112-381 të 01.12.2022, është i punësuar në pozitën e *Zyrtarit të Lartë Ligjor* pranë Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës, rezulton se ankuesi më datë 02.12.2024, ka parashtruar kërkesë me numër protokolli 14-120/06-158534/24 pranë Sektorit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, me pretendimin ankimor për realizimin pagesës për orë të plota për punë gjatë fundjavës, përkatësisht për ditët gjatë muajve Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor, duke bashkangjitur me këtë rast edhe orët shtesë.

Ndërsa, Menaxheri i Burimeve Njerëzor i Komunës së Prishtinës më datë 20.12.2024, ka nxjerrë Vendimin me Nr.14-101/03-0167712/24, mbi të cilin akt ankuesit i është refuzuar kërkesa për kompensimin e orëve shtesë për punën gjatë vikendit për muajt Gusht, Shtator, Tetor të vitit 2024, ndërsa i është aprovuar kërkesa për kompensimin e orëve shtesë për punën gjatë vikendit për muajin Nëntor të vitit 2025.

Ankuesi, kundër Vendimit të lartë theksuar ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për shkak të shkeljes së dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Rregulloren (QRK) Nr. 07/2023 për Kompensimin për kujdestari, punën gjatë natës dhe punën jashtë orarit të punës dhe Kodin Nr.06/L-074 nga organi përkatës i punësimit, duke kërkuar që të aprovohet ankesa, të anulohet akti kontestues dhe të obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Administrata Komunale, që të ndërmarrë të gjitha veprimet që ankuesit ti bëjë kompensimin për punën jashtë orarit të rregullt të punës të ditëve të fundjavës për muajt Prill, Maj, Korrik, Gusht, Shtator, Tetor dhe Nëntor 2024.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmerinë e ankesës ju referua dispozitave të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik, përkatësisht nenit 27 paragrafi 3, ku përcaktohet se: 3. *Nëpunësja/i civil ka të drejtë të paraqes ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e punës në shërbimin civil, si dhe dispozitave të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, përkatësisht nenit 124 paragrafit 1, ku përcaktohet se: 1. Pala ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative ndaj çdo veprimi apo mosveprimi administrativ, nëse pretendon se të drejtat apo interesat e tij juridike cenohen nga ky veprim apo mosveprim...,* ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 1 të këtij ligji, ku përcaktohet se: 1. *Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ,* dhe si rrjedhojë duke bazuar në kuadrin përkatës ligjor si dhe nga shqyrtimi dhe analizimi i provave të lëndës Kolegji konstatoi se ankesa e parashtruar nga ankuesi, me datë 21.02.2025 është e pasafatshme, ngase ashtu sikurse u tha me lartë në arsyetim të këtij vendimi, ankuesi kundër Vendimit me Nr.14-101/03-0167712/24, të datës 20.12.2024 të Menaxherit të Burimeve Njerëzor në Komunës së Prishtinës, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nga rrjedh se ankesa e datës 21.02.2025 është parashtruar jashtë afatit të përcaktuar me dispozitat e nenit **127 paragrafi 1** të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si e tillë është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ngase sipas shkresave të lëndës rezulton se ankuesi më datë 26.12.2024 ka konfirmuar pranimin e vendimit kontestues, të dërguar sipas shkresës elektronike zyrtare të datës 20.12.2024 nga Zyrtarja e Komunikimit, në Kabinetin e Kryetarit të Komunës së Prishtinës, e cila ndër të tjera thekson se : *të bashkangjitur gjeni vendimin mbi refuzimin e kërkesës me nr. të protokollit 14-120/06-158534/24, duke theksuar po ashtu se vendimi është i bashkangjitur edhe në intranet.*

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar nën 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi të hedhë poshtë ankesën si të pasafatshme, të filluar sipas ankesës me numër A.nr.349/2025 të datës 21.02.2025, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.349/2025

Atdhe GASHI

Procesmbajtës

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit A. G.;
- Udhëheqësit të Personelit në Komunën e Prishtinës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.